

LEF NOSI SI MBLEDHËS I FOLKLORIT NË ARKIVIN E IAKSA-ËS

Lef Nosi është një figurë sa e rëndësishme, aq dhe e veçantë. Janë të shumta provat të cilat dëshmojnë ndihmesën e këtij firmëtari të Pavarësisë në çështjen kombëtare. Ai lindi në lagjen *Kala* të qytetit të Elbasanit më 9 prill 1877. Mësimet e para i mori në vendlindje. Nisi dhe zhvilloi aktivitete patriotike, publicistike e studimore, duke u shndërruar në një ndër figurat më të njohura dhe me ndikim në vend. Më 1909 zgjidhet nënkryetar i klubit *Vllaznia* të Elbasanit e po këtë vit themelon dhe drejton shoqërinë *Afërdita*. Më 1912 zgjidhet ministër i Postë-Telegrafit në qeverinë e Vlorës. Pjesa më e madhe e punimeve dhe e koleksioneve të Lef Nosit gjendet më së shumti e ruajtur në AQSH, AFIKP, AIGJL.

Është një pasuri arkivore e përbërë nga dokumente, shkrime, dorëshkrime, e punime studimore të Nosit me natyrë biografike, politiko-shoqërore, gjuhësore, letrare, etno-folklorike, letërkëmbim me personalitete të kohës, etj. Nosi krijoi edhe një bibliotekë personale me mbi dhjetë mijë vëllime, me vlera albanologjike dhe ballkanologjike e cila sot gjendet në Bibliotekën Publike të Elbasanit dhe një pjesë në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Po ashtu ai ka meritën e shpëtimit të dorëshkrimeve të Anonimit të Elbasanit, Dhaskal Todrit, Kostandin Kristoforidhit. Lef Nosi zotëronte disa gjuhë, anglisht, frëngjisht, greqisht, turqisht, italisht. Ai dha gjithashtu ndihmesën e tij në mbledhjen e pasurive kulturore të popullit tonë në fushën e folklorit, në gjurmimin dhe mbledhjen e provave origjinale etno-zakonore dhe antropologjike. Situata në të cilën ndodhej shteti shqiptar, si dhe kushtet në të cilat punonte Lefi, duke pasur shumë bashkëkohës kundër asaj çfarë ai po bënte, Lef Nosi, bëhet ndër pionierët e ndërtimit të Shqipërisë kulturore, kërkues dhe promovues i jashtëzakonshëm i vlerave më të mira të krijuara ndër shekuj; paralelisht, mbledhja, dokumentimi dhe promovimi i këtyre vlerave autentike aq të lidhura organikisht me identitetin shqiptar, me origjinalitet dhe freski të pakundërshtueshme burimore, ndihmon dhe jep jetëgjatësi vetëdijes shqiptare.

Kërkimet e shumta, provat etno - kulturore të ruajtura e të përzgjedhura me kujdes nga Lef Nosi, si dhe dëshmitë e mbledhura drejtpërsëdrejti në popull, nga zona më të thella, bëhen dhe më të çmueshme sot pasi janë ndër kërkimet e para të kryera për shqiptarët nga vetë shqiptarët.

Nga kërkimet e bëra në Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, për Lef Nosit rezultojnë të ruajtura dokumente dhe letërkëmbime, të cilat janë vlerë për traditën etno-zakonore, për antropologjinë, për historinë, për gjeografinë, për demografinë e viseve shqiptare. Nuk është e rastit që materialet e mbledhura prej tij në terren, prekin të gjitha fushat e jetës, pasi ai ishte plotësisht i

vetëdijshëm për atë që po sillte, madje në organet publicistike të kohës theksohet fakti që Lefi ishte një mbledhës i folklorit.

Figura të tjera folklormbledhës të kohës janë edhe fretërit françeskanë (At Gjergj Fishta, At Vinçenc Prenushi, At Bernadin Palaj, At Donat Kurt etj). Tradita në vetvete është një tërësi vlerash, e cila është vlerësuar gjithmonë tek çdo popull si thesari më i shtrenjtë shpirtëror. Sipas studimeve antropologjike, strukturat dhe poetikat që lidhen me magjinë, mitet, ritet, doket, ceremonitë, besimet dhe sistemet simbolike, kanë lidhje logjike mes veti, pasi të gjitha bëjnë pjesë në kujtesën e kulturës popullore.

Fondi arkivor në IAKSA pranë Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë, përmban materiale të shumëllojshme, duke filluar nga fjalët e vjetra ose siç njihen në traditën gojore “fjalë plaka”, e duke vijuar më tej me epiken legjendare e atë historike, gjini këto që kanë pasur vëmendjen jo vetëm të Lef Nosit, por edhe të folkloristëve të tjerë e më pas edhe të studiuesve. Në këtë institut fondi ruhej jo me emrin e tij Lef Nosi, por i koduar.

Lef Nosi në AIKSA është kryesisht në dorëshkrim, ku një pjesë e tij është e palexueshme për shkak të degradimit të elementëve përbërës të njërive dokumentare të tij. Në të gjenden edhe materiale të daktilografuara, por që i përkasin periudhës së ruajtjes së fondit në arkiv, e kjo për shkak të rëndësisë që paraqisnin këto dorëshkrime. Në këtë fond i gjejmë të gjitha gjinitë folklorike, duke filluar me lirikën, me epikën historike dhe legjendare, baladën, prozën e shkurtër, llojet e nënlojet e saj, deri tek njësitë më të vogla folklorike, si gjëgjëzat, lodrat, etj. Fondi përbëhet nga 902 faqe të shkruara, 3385 këngë, 19 226 proverba, 1 066 gjëgjëza, 433 përralla. Materialet janë të grupuara në bazë të karakteristikës së tyre më të dallueshme, gjinisë së folklorit.

Lef Nosi me një personalitet të gjithanshëm, ka lënë gjurmë në shumë fusha të albanologjisë shqiptare. Kontributi i tij në studimet albanologjike përfshinte disa drejtime si në: gjuhësi, letërsi, etnofolklor, publicistikë, folklor. Në këtë kumtesë do vëmë theksin në të dhënat e mbledhura nga Nosi, në tematikat që përshkruajnë, në ruajtjen dhe respektimin e këtyre elementeve bazë dhe identifikues të lëndës së folklorit siç janë: gjuha, fjalët e vjetra, analizimi i karakteristikave të mbledhësit (Lef Nosit), qasjen e tij ndaj trajtesës teorike të kohës mbi folklorin. Rasti i etnologut Lef Nosi dëshmon vëmendje ndaj çdo detaji folklorik. Si rast të veçantë studimor kemi marrë këngët, të cilat janë të ndryshme, si ato të dashurisë, këngë erotike, këngë trimërie, këngë historike.

Zonat në të cilat janë mbledhur këto materiale janë: Luma-Kukësi, Hasi, Myç-Hasi, Elbasani, Libohova, Bllacë (Dibër), Macukull (Mat), Mat, Martanesh, Shkodër, Labinot, Gjirokastër, Myzeqe, Berat, Kosovë, Krujë, Delvina, Shkodër, Malësia e Shkodrës, Shkozë, Kabash, Gjakovë, Kaçanik, Pejë, Prizren, Drenicë, Shkozë-Mirditë-Gjakovë, Drenovë. Lef Nosi ruan me vërtetësi çdo të dhënë dhe fakt, duke plotësuar kështu një nga kriteret bazë të mbledhësit, besnikërinë ndaj

burimit. Duke iu referuar të dhënave të skedave dhe dosjeve të fondit Lef Nosi në AIAKSA, materialet e fundit të mbledhura prej Nosit datojnë në vitin 1944.

Në gjinitë e folklorit, pjesë e fondit Lef Nosi në AIAKSA bëjnë pjesë epika legjendare dhe epika historike, të cilat zënë rreth një të katërtën e fondit Lef Nosi në AIAKSA. Pjesa më e madhe e tyre rezultojnë të mbledhura prej Nosit midis viteve 1934-1940. Këngët janë mbledhur në zonat e Shqipërisë së Veriut (Gjakovë, Has, Drenicë, Prizren, Pejë). Lef Nosi mbledh këngë te epikës legjendare (*Muja e Halili, Kanga e Ago Ymerit, Deli Muja e Deli Mustaf Aga, Gjeta Basho Muji, Xberxber Elez Alia¹, Ymeri i shtatë vjet, Ymeri i Mujës, Xberxh Elez Alia dhe Kralevic Markë², Ali Bajraktari e Kralevic Markë³*).

Ndër gjinitë e tjera të folklorit të mbledhura prej Nosit janë edhe Këngët. Nosi mblodhi jo thjesht këngën si njësi folklori, por këngën si një dëshmitare dhe bashkëshoqëruese e individit gjatë gjithë jetës së tyre, si në rastet:

Teksti i mbledhur	Shenjime filologjike e arkeografike
<i>Mori e mira qi shkon me dhi, Me krabën pasqyr në gjë, Tuj shikjue, tuj vëzhgoue, Nan e babë kjoqshin bekue</i>	Malësia e Shkodrës AIKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 7. <i>kjoqshin, krahinoriz., qofshin.</i>
<i>Mori e mira shkon në krue,</i>	krue = krua, burim uji
<i>Po i gjan zogt tue fluturue, Fluturon po shko përpyetë, T'ana çikat shkun sivjet ...</i>	<i>gjan = ngjan; zogt = zogut.</i> Gjakovë AIKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 7.
<i>Mori e mira qerpik me rrema, M'u ka ba ni pik tu zemra; M'u ka ba ni pik e kuqe, Se m'ka shkue jaranesha nuse</i>	Kaçanik AIKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 7.
<i>Moj e mira synin larushkë, Ty t'a vrafsha moj qenin pushkë, - Cilin qen? - Qenin e zi - Erdha j'nat s'më la me hii</i>	<i>larushkë, dial., lloj rrushti i zi.</i> Malësia e Shkodrës AIKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 7.

Këngë historike ose trimërie

Këngët e mbledhura prej Nosit mund të kategorizohen si më poshtë: *këngë historike ose trimërie*, të cilat janë këngë që tregojnë bëmat dhe trimëritë e individëve të veçantë në krahinat apo zonat ku ata kanë jetuar si këngët: *Arif Poda; Jusuf bej Vrioni; Selo Picari; Ali Sabiti; Mustaf Agë Kryeziu; Xhelo Devolli; Ibrahim Ago Velçani, Cen Salibi pika e djalit, Ajetja e Dem Ahmetit, Ali Sabit (Bajraktar i Hasit), Nikoll*

¹ IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 15.

² AIKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 7.

³ IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja, nr. 15.

Gjoka prej Gojani, Halil Kastrati etj.

AF1 (Lef Nosi) Fletore 120/III, fq. 28. Vargje 178, këngë 16. Rrethe të ndryshme 1935-1936

1. *Ali Sahit (Bajraktar i Hasit) (Kukës-Lumë 1935-1936)*

Vesel Pasha ndez kamishin:
 Kush m'a thurret Ali Sahitin?
 Ti, ç'i je Ali Sahiti.
 Isuf Xhoki flet një fjal:
 Sod e njofta Hasn e Par!
 Kish do djem për faqe t'bardh,
 Shkojn Gabratit si me kan atllar,
 Për pa u ra pushka në ball,
 Ato kurr nuk din me u ndal!

2. *Halil Kastrati (Kukës-Lumë 1935-1936)*

Frini era, na u çel taraba,
 Çou Halil se Avdil Aga,
 Me treqind sejmën për mrapa,
 T'atn n'opanga pa çorapa.
 Fetah Syla një çen çafiri,
 Bani gost e çoj e na thirri,
 Mish e pite na gostiti,
 Coj për mizhde të Veziri;
 Mizhde, Pash, se u zu Halili.

3. *Nikoll Gjoka prej Gojani*

Ç'asht një mjegull që del prej detit?
 Nuk asht mjegull, as nuk asht breshën,
 Nuuk asht breshën me duhi,
 Ç'aj Nikoll Gjoka me djel t'ri,
 Drejt për s'drejt ke mbreti ka hi.
 T'u gatët jeta, mret i ril!
 T'u gatët, ty more djall!
 Pse del n'mal me çeverri?
 S'kam dal n'mal me çeverri,
 Jam gatrreue me shokt e mi.
 Pse e ke marr thot, at alti?
 Pak asht nja po kam çef për dy.

Këngë dashurie

Këngët e dashurisë janë pikërisht ato këngë të cilat për nga rëndësia dhe shtrirja që kanë pasur në popull gjejnë vëmendjen e çdo mbledhësi, përjashtim të cilin nuk do ta bënte as Nosi. Këto këngë janë të mbledhura pothuajse kudo, nga veriu, Shkodra kryesisht, Peja, Gjakova etj., e deri në jug në pikat më të largëta si Gjirokastra e Leskoviku. Shqipëria e Mesme do të përfaqësohej më së miri me qytetin e Elbasanit, i njohur për këngët e shumta të këtej lloji. Vitet e mbledhjes sillen mes 1926 dhe 1938. Edhe tek këto lloj këngësh, por edhe tek të tjerat liriket, shoqërorët, erotiket, në më të shumtën e rasteve është shënuar mbledhësi dhe vendi. Këngët e dashurisë edhe tek Nosi njohin tipare dhe karakteristika si tek të gjitha këngët e dashurisë. P. sh., njihen këngët ku malli dhe dëshira dëshmojnë dashurinë për vashën a trimin. Të tilla në dosjet e Nosit gjejmë si: *Zanë të dy sytë me dyshimet*, *Qysh ta shkojmë këtë verë e këtë beharë*, *Da dy ditë qi hyri vera*, *Atje lart n'atë dardbë*, *Djelli buzës së malit*.

<i>Më vret djalë kur më shikon, Me ato sy posi petrit Me dy barqe po m'shinon, Me j'shigjet m'ke godit.</i>	AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i> , Dosja nr. 4. <i>shinon</i> , dialekt., <i>shenjon</i> .
<i>Me gazep dylberi m'foli E s'm'a hudhi noj selam, Me shpatët t'bukuris më sollë, E m'a lshoi kryet ndër kamë,</i>	AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i> , Dosja nr. 4. <i>gazep</i> , turq., <i>mundim</i> , Dizdari : 239. <i>selam</i> , turq., <i>përsbëndetje</i> . <i>shpatët</i> , shumës i emrave asnjanes; <i>sollë</i> , dialekt., <i>goditi</i> . <i>lshoi</i> = <i>lëshoi</i> . <i>kryet</i> , dialekt., <i>kokë</i> . <i>kamë</i> , dielekt., <i>këmbë</i> .
<i>Ç'ash ky yll që len n'sabah, Rrezet po i lshon, Mos kë frikë se ban gjynah,</i>	AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i> , Dosja nr. 7. <i>ç'ash</i> = <i>ç'është</i> ; <i>len</i> = <i>lind</i> ; <i>sabah</i> , turq., <i>mëngjes</i> , <i>ban</i> = <i>bën</i> ; <i>gjynah</i> , turq., <i>mëkat</i> ,
<i>Pse flet e kwendon, Plasi ashiku së qari, Takat ma si ka met, Djalin çe mur muhyrdari, Ti falesh me shëndet,</i>	Dizdari 2005: 315; <i>kwendon</i> = <i>bisedon</i> ; <i>ashiku</i> , turq., <i>dashnor</i> , <i>takat</i> , turq., <i>fuqi</i> , <i>met</i> = <i>mbetur</i> ; <i>mur</i> = <i>mori</i> . <i>myhyrdar</i> , turq., <i>mbajtësi i vullës</i> , <i>zyrtari</i> .
<i>Mjertë na qi u-bamë ashik, Vum belan e gjithë dynjan, S'më zë gjumi nat'e dit, Nga sevdaja qi m'ka zan</i>	<i>mjertë</i> , dialekt., formë e rrallë, <i>të mjerët</i> ; <i>ashik</i> , turq., <i>dashnor</i> ; <i>bela</i> , turq., <i>ngatresë</i> ; <i>dynja</i> , turq., <i>botë</i> , <i>jetë</i> ; <i>sevdaja</i> , turq., <i>dashuria</i> , <i>zan</i> = <i>zënë</i> . AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i> , Dosja nr. 4.

Njihen dhe shihet edhe tek këto këngë ndërfitja aty këtu e ndonjë elementi

erotik. Na dalin këto këngë: *Mori e mira shkon në krue, Kajka e Sahit Tropojës, Plaku, Ç'deshe ti moj lule gjer në lumët, Sa të kam kërkuar mezi të kam gjetur, E mir boll del në shkall, Moj e mira flokt e verdha, Atje poshtë nd'ata lisa, Moj e mira qi shkon më dhii, Moj e mira syrin larushk, Mori e mira n'derë t'stanit, Mori e mira natën si bora, Mori e mira n'bie t'manit, Mori e mira pika-pika, Mori e mirë qi shkon me lopë, Mori e mirë e hollë e gatë.*

<p><i>More djal keqfshim hidhnue, ç'e do nusen tue pas mue? Nuses cicat i jan vjetruë, E j kam t'miat fort si ftue,</i></p>	<p>Malësia e Shkodrës AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i>, Dosja nr. 7. <i>keqfshim</i> = <i>qofshim</i>; <i>hidhnue</i>, dialekt., <i>hidhënuar</i>; <i>cicat</i>, krahin., <i>sisë, gjoks, kra-</i> <i>haror.</i></p>
---	--

Evidentohen zonat nëpër të cilat këndohen këto këngë që në traditën tonë popullore kanë qenë zonat malore, fshatare e baritore.

<p><i>J'asaj rruge (ish) tuj ardh një djalë, Ish tuj korr syzeza n'arë, Puna e mbarë syzeza e bardhë.</i></p>	<p><i>j'asaj</i>: dialekt., <i>njasaj</i>; <i>tuj</i>, dialekt., <i>duke, duke ardhur.</i> Veri AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i>, Dosja nr. 5.</p>
<p><i>Mori e mira n'derë t'stanit, Lsboi ogjct e qiti malit.</i></p>	<p>Pejë. AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i>, Dosja nr. 7. <i>ogjct</i>, sllav., <i>qingjat</i>; <i>stan</i> = <i>vathë, grigjë</i>, <i>qiti</i> = <i>nxirri.</i></p>

Këngë liriko-shoqërore

Për sa i përket këngëve liriko-shoqërore tek Nosi i hasim me tema të ndryshme, siç janë ato kushtuar nizamit, e deri tek ato që kanë të bëjnë me rite të punës së përditshme ,ose, p.sh., raste të lirikës tonë popullore në të cilat evidentohet varfëria. Të tilla gjejmë këngët si: *Kush e pi rakin e butë, Një dervish që rri në portë, Na vjen filxhani rreth, Mora kalin shkova tatëpjetë, Bie shi e bie borë- Ka pasë nëna dy jetima*, AF1 (*Lef Nosi*) Fletore 120/III, fq. 25. Vargje 340, këngë 20. Rrethe të ndryshme 1934-1940: Vendi-Labëri.

Edhe tek Nosi e gjejmë me versionin e këngës *O kungull t'u shoft fara, ku shkoj të gjej përpara*, apo në versione të ngjashme të së njëjtës këngë.

<p><i>Vjesht e par,</i> <i>Mujth i mar,</i> <i>Se vjelin,</i> <i>E mbjellin bota</i> <i>Vjesht e mesme.</i> <i>E ka hesën e gjeçme,</i> <i>Se rrushi vilet,</i> <i>Rakija zibet,</i> <i>Driti melidhet ...</i></p>	<p><i>mujth, deminut., muaj.</i> <i>hesën e gjeçme, nga konteksti: hisen e gjetsbme,</i> <i>pjesë e sigurtë, sasi e garantuar e prodhimit bu-</i> <i>jqësor.</i> <i>melidhet, dialekt., mblidhet</i> Shelcan, Elbasan AIKSA, Fondi <i>Lef Nosi</i>, Dosja nr. 10.</p>
--	---

Bibliografi:

Arkivi i Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit:

- IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 4.
- IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 5.
- IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 7.
- IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 10.
- IAKSA, Fondi Lef Nosi, Dosja nr. 15.